



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 15 qershor 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mori pjesë si deputete e interesuar: Alma Lama

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Hivzi Islami, Zija Bylykbashi, Lendita Pula dhe Vjollca Hykolli - ASHA, Dino Asanaj, Avni Jashari, Naim Avdiu dhe Shkëlzen Lluca - AKP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit, për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryesuesi - Pasqyrat financiare të hartuara nga ZAP-i janë vlerësuar pozitivisht. Lëshimet nga ASHAK-ja janë kryesisht teknike. Ka lëshime të regjistrimi i pasurisë nën 1000 euro dhe të proceset e prokurimit. Po ashtu ka vërejtje të blerjet e tjera, të pasuritë kapitale dhe jokapital dhe të sistemi i kontrollit të brendshëm. Kërkoj sqarim lidhur me këto lëshime.

Hivzi Islami, nënkryetar – ASHAK-ja është një organizatë e vogël buxhetore. Shkelje të mëdha në AKSHAK nuk ka. Shkeljet janë më tepër të natyrës procedurale.

Zija Bylykbashi – Ka pasur bashkëpunim të mirë ndërmjet ZAP-it dhe ASHAK-së. Akademia ka pasur problem sa i përket stafit, sepse buxheti është i vogël. Është kërkuar nga NJQHAB-ja që ta caktojë një auditor të brendshëm. Bëxhet e viteve të mëparshme janë marrë parasysht, domethënë edhe ky lëshim është evituar. Shpalosja e pasurive financiare nën vlerën 1000 euro, ky është në proces të implementimit.

Armend Zemaj – Ky Komision ka për detyrë të kujdeset për shpenzimin e parasë publike. Akademisë i mungon kontrolli i brendshëm. Sugjerimet që kanë dalë nga ZAP-i dhe nga Komisioni duhet të merren si reale. Përkrahja për Akademinë mungon dhe me këtë Qeveria nuk do të ketë përkrahje, sepse po të ishte e interesuar Qeveria do ta rriste numrin e stafit të brendshëm.. Është një tendencë e politizimit edhe të këtyre institucioneve. Megjithatë raportet e auditorit nuk duhet të shihen si trysni politike, por si diçka reale që e ndihmojnë shkencën.

Ramiz Lladrovci – Akademia ka paraparë për vitin 2010 shtim të stafit dhe për këtë janë ndarë mjetet. Tani Akademia është në suficit. Pse nuk është pranuar stafi dhe a ka qenë fjala për staf akademik apo për staf mbështetës? Akademia e ka marrë një faturë pa u hapur tenderi, pse është pranuar fatura? Te procedurat e dhënies së tenderit thuhet se duhet të sillet një vërtetim nga administrata tatimore e Kosovës, që nënkupton se janë kryer obligimet ndaj shtetit. Te blerja e biletave, është paguar një shumë më e madhe se ç'është paraparë. Përdërisa nuk shpenzohet buxheti i ndarë nuk ka mundësi t'i ndahet buxhet më i madh Akademisë.

Hivzi Islami, nënkryetar - Suficiti është edhe i stafit akademik edhe i stafit mbështetës. Zgjedhjet janë çdo 4 vjet dhe para 2 vjet e gjysmë është dashur të kërkohen mjete për anëtarët e rinj që do të vijnë. Mjetet janë ndarë për dhjetë anëtarë të rinj. Zgjedhjet janë mbajtur dhe janë pranuar vetëm tre anëtarë, sepse edhe shtatë persona të tjerë nuk i kanë marrë votat e mjaftueshme. Vërejtja ka qenë për katër ose për pesë punëtorë financiarë, mirëpo është menduar të mos dëmtohet buxheti i Kosovës, kur vëllimi i punës është shumë i vogël. Për biletat Akademia ka bashkëpunim ndërkombëtarë dhe nuk ka kapacitet t'i mbulojë. Tani bashkëpunon me agjencitë, por nuk mund të dihen saktë thirrjet e takimeve. Çështja e botimeve - me 3000 ose 4000 euro Akademia boton një libër. Suficiti në buxhet ka të bëjë vetëm për pagat, ndërsa kategoria mallra dhe shpenzime është shpenzuar në tërësi.

Muhamet Mustafa – Çështja e prokurimit dhe e auditimit të brendshëm mund të bëhet në bashkëpunim me ndonjë organizatë tjetër buxhetore. Për çështjen e recensuesve duhet kërkuar një zgjidhje me APP-në dhe me OSHP-në.

Zija Bylykbashi – ASHAK- Suficiti nuk është si pasojë e keqmenaxhimit, por ka të bëjë me pagat. Akademia zotohet se në të ardhmen nuk do të ketë lëshime të tilla.

PËRFUNDIM

Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryesuesi - Opinioni i ZAP-it është “Opinion i kundërt”. Kërkoj nga përfaqësuesit e AKP-së që të japin sqarime lidhur me gjendjen e rekomandimeve nga viti i kaluar. Te Pasqyrat financiar, të dhënat nuk janë të besueshme nga aspekti i rregullsisë, raportimi tremujor nuk është transparent, kategorizimet e gabuara, avancat e pambyllura, mungojnë dëshmi për formimin e komisionit për pranimin dhe për dorëzimin e ofertave - duhet një anëtarë i huaj, kualifikimi i operatorëve të papërgjegjshëm, vonesa për njoftimin në oferta, neglizhimi në nënshkrimin e kontratave, procedura jo të rregullta gjatë kontraktimit të shërbimeve këshillëdhënëse, si për ndërtimin e hotelit, – privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, angazhimi i këshilltarit, këto të gjitha kanë të bëjnë me ndërmarrjen “Sharr-Cem”. “Sharr-Cemi” ka qenë në një fazë në komercializim. Sa është mbikëqyrur procesi i komercializimit dhe a ka pasur vërejtje? Prezantimi i hapësirave tokësore te pjesa e amortizatorëve, mosrespektimi i politikave dhe i rregullave të tenderit gjatë ngarkimit dhe tarifave tenderuese - dikë e keni ngarkuar - trajtuar me 1000 e uro e dikë me 2000 mije euro. Politikat e rregulloreve të tenderit, sa i përket afatit të kthimit të depozitave të ofertuesve dhe të jofituesve, shpërndarja e 20%, kontrolli mbi menaxhmentin, nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme.

Dino Asanaj – Auditimi në fakt ka të bëjë me pasqyrat vjetore të Fondit të Mirëbesimit e jo të Fondit të Privatizimit. AKP-ja është institucioni i fundit, që lidhet me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që e ka filluar UNMIK-u, pastaj ka vazhduar në Departamentin për Tregti e Industri dhe në AKM. AKP-ja e ka trashëguar edhe obligimin e respektimit të të gjitha të drejtave dhe të detyrimeve që rrjedhin edhe nga kontratat e nënshkruara në atë periudhë. Zyrtarët e ZAP-it nuk kanë njohuri të mjaftueshme për operimin e Agjencisë. AKP-ja nuk pajtohet me Raportin e ZAP-it për këto pasqyra.

Çështja e Kllokotit, ka të bëjë me vitin 2006. Në atë kohe AKP-ja nuk ka ekzistuar. Në qershor 2008 nuk është bërë pranim-dorëzimi i drejtë i dokumentacioni që është gjetur në mbeturina, dhe i djegur. Shpërndarja e 20%- AKP-së ka arritur ta gjejë një metodë lidhur me këtë.

Avni Jashari – Dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara si vijon: Rekomandimi i parë që nuk është adresuar – është fjala për disa nënkontrata, që për arsye se ishin jashtë kontrollit të AKP-së nuk kanë mundur të nënshkruhen në periudhën brenda 90 ditësh, sipas rregullave të tenderit, ose brenda 30 ditëve sipas politikave operacionale. Pengesë kanë qenë edhe ndryshimet e kadastrave, që është dashur të bëhen në disa komuna dhe mospajtueshmëria midis organeve. Ato 9 kontrata AKP-ja do t'i adresojë sa më shpejt. Sa i përket funksionit të kontrollit të brendshëm mund të thuhet se NJAB-së i kanë mbetur pa u adresuar në vitin 2010. Avanca - fondi i likuidimit i ka 180 milionë euro. E gjetura e auditorit ka të bëjë me 39 mijë euro, që në përqindje nuk është e madhe. Megjithatë sipas LMFP-së dhe akteve normative, shpenzimet nga fondi i likuidimit me asnjë akt normativ nuk kërkohet që paratë e imta të mbyllën në fund të vitit fiskal.

Shkëlzen Lluka – AKP-ja ka raportuar në Kuvend, por vërejtja ka qenë se raportet nuk janë publikuar - kjo e gjetur është adresuar. AKP-ja i ka formuar komisionet për hapjen e ofertave, d.m.th. kjo e gjetur është adresuar në momentin që AKP-ja e ka marrë Raportin e ZAP-it. Kualifikimi i operatorëve të papërgjegjshëm – që nga sot AKP-ja ka filluar me shfaqjen publike të procesit të dorëzimit të ofertave përmes faqes së AKP-së. Vonesa në njoftimin ofertuesve – është fjala për vonesën prej një dite. Agjencia i ka trashëguar 140 kontrata të panënshkruara. Agjencia e bën njoftimin për pagesën e fituesit të mundshëm për pagesën e 25%, pastaj e fillon

përpilimi i kontratave. Pasi të bëhet pagesa e dytë, policia e heton blerësin. D.m.th. e gjitha nuk varet nga AKP-ja, pasi që nuk mund të dihet se kur kryhen hetimet. Në raste të caktuara ka vonesa në mosazhurnimin me kohë të fletave poseduese dhe të kopjeve të planit nga zyrat kadastrave nëpër komuna.

Sipas ZAP-it AKP-ja e ka nxjerr një rregullore të brendshme, sipas së cilës rregullohen furnizimet e brendshme që financohen nga llogaritë e fondit të privatizimit. Ky është konstatim i gabuar, sepse kjo rregullore i rregullon procedurat për fondet që nuk i takojnë të hyrave nga privatizimi ose nga likuidimi. Kontraktimi i shërbimeve këshillëdhënëse për privatizimin e ndërmarrjes “Sharr-Cem” është bazuar në përpikëri me procedurat e brendshme të prokurimit prej burimeve financiare nga operacionet e ndërmarrjes shoqërore. Këto mjete nuk janë para publike dhe nuk i nënshtrohen prokurimit publik. Megjithatë me qëllim të transparencës AKP-ja i ka zbatuar disa parime të Ligjit të prokurimit publik, e ka shpallur tenderin dhe e ka krijuar komisionin, ashtu siç ndodh edhe te prokurimet publike. Në rastin e parë AKP-ja i ka pasur vetëm dy oferta dhe prokurimi si i tillë ka dështuar. Me vendim të Bordit prokurimi është bërë në bazë të rregullores së brendshme dhe me këtë rast interesimi ka qenë më i madh.

Devijimi i procedurave të devijimit të “Sharr-Cem” - Kontrata e nënshkruar në vete e ka pasur edhe nenin 4.7, ku parashihet e drejta e blerjes dhe interpretimi i këtij neni nga ZAP-i është bërë në mënyrë të gabueshme. AKP-ja ka kontrata ku decidivisht sqarohet çka është e drejta e parablerjes. Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve rreth çmimit të shitjes ka qenë arbitrazhi. Në lidhje me transparencën në këtë rast Agjencia me kohë i ka njoftuar të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Po ashtu Bordi e ka formuar Komisionin për Privatizimin e “Sharr-Cemit”. Bordi ka njoftuar me vendim për rrjedhën e këtij procesi. Lidhur me atë nëse është arritur vlera e tregut mund të thuhet se është një prej transaksioneve më të mëdha të kryera gjatë privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe duke e pasur parasysh se kontrata me komercializuesin do të skadonte me një dhjetorë, këshilltari i transaksionit e ka bërë vlerësimin para se të hyhej në negociatë. Në Raportin e ZAP-it mungojnë disa njoftime: nuk është shqyrtuar mirë raporti i ekspertit të industrisë së çimentos, që është marrë vetëm me këtë çështje. Nuk është shqyrtuar kontrata e shitjes së aksioneve. Agjencia gjatë negociatave ka arritur që investitori të kryejë investime në vlerë prej 35 milionë euro gjatë periudhës 5-vjeçare. Pas kësaj periudhe do të kryhet auditimi me renome ndërkombëtare për përmbushjen e zotimeve në investim. Nëse ka diferencë, vlera e mbetur do të paguhet si pjesë e çmimit. Po ashtu pjesë e kontratës ka qenë të sigurohet punësim i qëndrueshëm për të gjithë punëtorët në listën aktualen për tri vjetët e ardhshme. Po ashtu është kërkuar që punëtorët në skemën sociale të paguhen edhe për një vit.

Çështja ambientale – Blerësi ka marrë përsipër rehabilitimin e vendndodhjes ku është kryer ekstraktimi i argjilës.

Naim Avdiu – Komercializuesi që kishte dështuar në përmbushjen e marrëveshjes së zotimit shpërblehet me kontratë të privatizimit. Kjo ndërmarrje i është dhënë me kontratë 10-vjeçare qiradhënie kompanisë *Egi Bau* me 16 shtator 2002. Sipas auditorit të angazhuar nga AKP-ja qiramarrësi nuk ka paguar qira për periudhën deri në shtator të vitit 2009, domethënë pas periudhës 7-vjeçare të kontratës së komercializimit - përmbushja e zotimeve për investime kapitale ishte 1 milion e 105 mijë e 251 euro. Gjatë kësaj periudhe punësimi minimal ishte 22 punonjës, ndërsa ai maksimal 26 punonjës dhe sipas Raportit të auditorit qiramarrësi nuk ka paguar qira për krejt këtë periudhë. Faktin e mospagesës qiramarrësi e arsyeton me pamundësinë e shfrytëzimit të një pjese të kësaj hapësire, si pasojë e uzurpimit të kësaj pjese nga një palë e tretë. Në nenin 5 të kontratës së komercializimit theksohet: “Në rast se e drejta për shfrytëzimin pa prishje të qetësisë është penguar apo e drejta për shfrytëzim pa prishje të qetësisë është ndaluar në mënyrë të përhershme, qiradhënësi duhet ta kompensojë në mënyrë adekuate qiramarrësin për periudhën e pengimit apo ndalimit. Për këtë qëllim kompensimi adekuat duhet të bazohet në kalkulimin e rrjedhjeve zbritëse të parasë së gatshme. Obligimi i qiramarrësit është për ta bërë dënimin sa më të vogël.” AKM-ja kishte dështuar ta siguronte shfrytëzimin pa prishje të qetësisë. AKM-ja e kishte paditur uzurpatorin dhe vendimi lidhur me këtë është marrë nga gjykata katër vjet më vonë, domethënë në vitin 2006. Ky vendim është ekzekutuar më 2010. Sipas ZAP-it sipërfaqja e uzurpuar është 952 metër katrorë nga gjithsej 5803 metër katrorë,

mirëpo e anashkalojnë faktin se të uzurpuara ishin dyqanet e shitjes me pakicë, depoja për shitjen e materialit dhe zyra.

Procesi i monitorimit – CRK-ja e ka marrë të drejtën të drejtë, të operojë, të mirëmbajë dhe ta shfrytëzojë kompleksin industrial, me qëllim që ta vazhdojë aktivitetin prodhues sipas kushteve të parashtruara në kontratë që janë: zotimet për investime në vlerë prej 1 896.000 euro, zotimi për punësim në rangun prej 40 deri 180 punonjës dhe pagesa e qirasë vjetore prej 9203 euro. Auditimi i pavarur për qëllime të monitorimit e përfshin periudhën deri me 5.10. 2010 dhe është konfirmuar që qiramarrësi i ka përmbushur zotimin në investime në vlerë prej 1 904 393 euro në përqindje 57.69%, duke mos e marrë parasysh shumën prej 412 792 euro që qiramarrësi i ka realizuar jashtë planit investiv të kontratës së komercializimit që ka të bëjë me objektin e administratës. Kjo do ta rriste dhe do ta përmbushte zotimin në vlerë prej 1 507 000 euro, 79.45%. Numri mesatar i punonjësve në ndërmarrje është 104, që nga numri maksimal i zotuar paraqet këtë përmbushje prej 57.77% dhe ka një përmbushje prej 99.99% në pagesën e qerasë. Që nga 9. 3. 2006 *Fapoll* si pjesë e ndërmarrjes Trepça ka qenë nën moratoriumin e dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme, ndërsa më 26. 1. 2011 dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka marr vendim t'i pezullohet moratoriumi i disa aseteve jothelbësore të ndërmarrjes së Trepçës, ku bën pjesë edhe ndërmarrja shoqërore *Fapoll*. Si rezultat i kësaj AKP-ja e ka inkorporuar këtë ndërmarrje në listën e ndërmarrjeve që planifikohen të privatizohen gjatë vitit 2011 dhe me siguri do të jetë në valën e 51-të, që është vala e ardhshme e privatizimit. Një sqarim tjetër shtesë lidhur me kontratat e komercializimit - në përgjithësi të gjitha kontratat e komercializimit nuk parashikojnë aplikim të ndëshkimeve për mospërmbushje të zotimeve.

“Sharr Salloniti”? - E gjetura sipas Raportit të auditimit në pikën e detyrimeve kontingjente është ndërtimi i objektit afarist hotelier në vlerë prej 693 256 euro pa miratim nga Agjencia. Kur thuhet se nuk ka pasur miratim duhet të precizohet ose të specifikohet se në aspektin formal mungon përgjigjja me shkrim e AKP-së për miratimin e planit investiv të ndërmarrjes shoqërore. Mirëpo duhet cekur se njësia e administrimit të drejtpërdrejtë e ka pranuar planin investiv të ndërmarrjes shoqërore dhe të njëjtin nuk e ka kundërshtuar. Neni 6.1 i Ligjit të AKP-së nuk e precizon se miratimin e planit të biznesit dhe të planeve investive të ndërmarrjes duhet ta bëjë Agjencia në formë të shkruar ose në formë të miratimit formal. Në kuadër të kompetencave të Agjencisë për ndërmarrjet specifikohet edhe miratimi i planit të biznesit dhe i planit për investime pa sqarimin se a duhet të jetë më shkrim. AKP-ja, respektivisht njësia e administrimit të drejtpërdrejtë, ka qenë nën mbikëqyrje të të gjitha procedurave, që kanë të bëjnë me ndërtimin e objektit. Këto procedura përfshijnë shqyrtimin e planit investiv dhe pranueshmërinë e tij si të favorshëm për ndërmarrjen, publikimin e tenderit, pranimin dhe hapjen e ofertave nga komisioni i caktuar nga ndërmarrja shoqërore, akt që ka ndodhur në objektet e AKP-së në praninë e zyrtarit të administrimit të drejtpërdrejtë, procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm, që mbikëqyret nga ana e zyrtarit të administrimit drejtpërdrejtë, kontratën e ndërtimit që është hartuar nën mbikëqyrje të AKP-së dhe të Departamentit Ligjor. Në nenin 8 të kontratës së ndërtimit shihet qartë se AKP-ja mund të formojë një komision të pavarur mbikëqyrës për ta përcjellë implementimin e të gjitha punëve deri në dorëzimin e objektit. E gjetur tjetër lidhur me këtë objekt është se përzgjedhja e operatorit të kompanisë ndërtuese të objektit afarist hotelier është bërë pa procedura të rregullta. Pra, janë përdorur procedurat e prokurimit të ndërmarrjes shoqërore, si edhe janë shfrytëzuar mjetet e gjeneruara nga ndërmarrja shoqërore dhe procesi është bërë nën mbikëqyrjen e njësisë së administrimit të drejtpërdrejtë të AKP-së. AKP-ja ka ofruar dëshmi të mjaftueshme rreth mënyrës së përzgjedhjes së operatorit fitues, e ka ofruar dosjen e tenderit, publikimin e tenderit, raportet e komisioneve vlerësuese të ofertave, vendimin për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm dhe kontratën e ndërtimit me fituesin e tenderit. Mendojmë se këto e kanë qenë bazë e mjaftueshme për ta kuptuar si është zgjedhur operatori fitues. Po ashtu zyrtarëve të ZAP-it i janë dorëzuar edhe raporti final për kryerjen e punëve dhe komplet dosja e të gjithë ofertuesve me projektet e tyre ndërtimore. Bordi i ndërmarrjes “Sharr Salloniti” e fillon ndërtimin e objektit hotelierik afarist pa marr leje nga komuna e Hanit të Elezit. Raporti ka filluar të bëhet edhe para se të merret leja nga komuna, kontrata është e nënshkruar me 28 gusht 2009, kurse vendimi nr. 0671/09 për dhënien e lejes ndërtimore është dhënë më 8 shtator 2009, konkretisht pas 11 ditëve. Është çudi e madhe se data e nënshkrimit të kontratës mund të konsiderohet si datë e fillimit të punëve. Data e nënshkrimit të kontratës nuk

është datë e fillimit të punës. Përkundër krejt kësaj është neglizhuar fakti se ndërmarrja shoqërore e ka pasur pëlqimin e Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Hanit të Elezit. Ky vendim është lëshuar me 30. 6. 2009. E gjetura tjetër që ka të bëjë me këtë ndërmarrje shoqërore është se pa u ndërtuar objekti afarist Bordi i AKP-së merr vendim ta privatizojë këtë ndërmarrje. Detyra e administrimit të drejtpërdrejtë është kontrolli i drejtpërdrejtë në menaxhimin e ndërmarrjeve, përmirësimi i afarizmit të NSH-së, në mënyrë që problemet të eliminohen dhe vlera e saj të jetë sa ma e madhe. Ne mendojmë se pikërisht me administrim të drejtpërdrejtë është arritur kjo, pra i është rrit vlera një ndërmarrje që ka qenë e pastruar dhe i janë dhënë pare për ta dekontaminuar prej asbestit krejt ambientin që e rrethon atë ndërmarrje. Një ndërmarrje e tillë pa kurrfarë pasurie, përpos tokës dhe objekteve gjysmë të rrënuara, është bërë që në procesin e privatizimit ta arrijë një çmim prej 8,9 milionë euro. Do të thotë një ndërmarrje pa asete prodhuese është shitur për 8.9 milionë euro. Mendojmë se AKP-ja në procesin e administrimit të drejtpërdrejtë të saj e ka bërë atë çka e parasheh neni 6.1 i Ligjit të AKP-së, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pasurisë së ndërmarrjeve shoqërore, andaj na duket e pa kuptimtë kjo vërejtje.

Ramiz Lladrovci – Pse është bërë pranimi i ofertave, për shërbime këshillëdhënëse në formë elektronike? Vlera e ndërmarrjes është përcaktuar nga këshilltari. Kush e ka negociuar çmimin e shitjes së ndërmarrjes “Sharr-Cem”? Për shitjen e ndërmarrjes “Sharr-Cem”, AKP-ja i është drejtuar me një letër të gjitha institucioneve në Kosovë. Çka do të thotë kjo? A do të thotë që edhe pse janë bërë shkelje të ligjit mund të amnistoheni? Nuk është bindës arsyetimi se “Sharr-Cem-i” do të shitej më lirë nëse do të qitej në tender. Pastaj dokumentacioni ruhet nga administrata jo nga Bordi. Pyes: Stafi i administratës me kalimin e AKM-së në AKP, a ka vazhduar të jetë i njëjti?

Armend Zemaj – Raporti i auditimit reflekton më shumë në privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Fjala është për kompaninë që përfshin më shumë se 42% të të hyrave të përgjithshme. Pyeti: ku bazohen përfaqësuesit e AKP-së se auditori, kur nuk e ka kuptuar punën e AKP-së? Sipas ligjit shitja bëhet me tenderim, ndërsa AKP-ja ka shkuar me anë të negociatave të drejtpërdrejta. Ku ka gjetur mbështetje AKP-ja për zbatimin e kësaj procedure? Sa konkretisht është shitur “Sharr-Cem-i”? A janë inkasuar të hyrat? Si ka mbetur çështja e ekzekutimit të kontratës? Kush do ta bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës? A kanë fituar punëtorët, në radhë të parë komuna dhe çka ka fituar Kosova me shitjen e kësaj ndërmarrjeje? Çka është paraparë të ndërmerret për ruajtjen e ambientit në atë territor të Kosovës?

Albert Kinolli – Kush e përcakton çmimin e tregut dhe në bazë të cilave kriteret? A ka te drejtë që një institucion tjetër ta bëjë vlerësimin e këtij çmimi të tregut? A ka të drejtë ankese? A mund të bëhet ndërtimi i objektit hotelier pa miratim nga Agjencia? Raporti i ZAP-it bie në kundërshtim me atë që e dëgjoi Komisioni nga AKP-ja. ZAP-i nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme rreth ofertuesit fitues për ndërtimin e hotelit. Mungonte dosja e tenderit të përgatitur nga autoriteti kontraktues, si dhe kriteret për përzgjedhjen e operatorit ekonomik ishin të paqarta. Zyrtarët e AKP-së lidhur me këtë dhanë përgjigje se e kanë ofruar dosjen e tenderit. Domethënë ka shumë kundërshtime midis të asaj çka përmban Raporti dhe asaj çka prezantuan zyrtarët e AKP-së para Komisionit. Konkluzioni i ZAP-it se *“mangësitë e vërejtura në lidhje me procesin e privatizimit në përgjithësi janë shumë serioze dhe orientojnë në një kontroll të dobët brenda AKP-së.”* Kjo, në mungesë të fakteve, është akuzë e rëndë dhe mund të ndikojë negativisht te qytetarët.

Mursel Haljilji - Sipas Raportit shihet qartë se janë bërë disa lëshime në procedurat e zhvilluara për “Sharr-Cemin”, që është një ndërmarrje e madhe. Si është e mundur që një ndërmarrje kaq e madhe të privatizohet në mënyrë jo të rregullt. Nuk është në pyetje çmimi. Vetë fakti se nuk ka pasur ofertues ka ardhur deri të shkelja dhe te dëmtimi i buxhetit të Kosovës. Ndoshta çmimi do të ishte dhe më i vogël, mirëpo procesi do të ishte i ligjshëm. Nuk është transparencë nëse lajmërohen institucionet, por nëse procesi kryhet sipas ligjit.

Alma Lama – Sipas Raportit të ZAP-it në AKP ka shkelje të jashtëzakonshme dhe procesi i privatizimit është shoqëruar me parregullsi të jashtëzakonshme. Privatizimi i ndërmarrjes “Sharr-Cem”, që në fakt nuk është privatizim, por shitje, është bërë në kundërshtim të plotë me bazën ligjore të AKP-së që thotë se siguron të drejta të barabarta për të gjithë investitorët. Përfaqësuesit e AKP-së mbështeten në kontratën e vitit 2000 për një të drejtë të parablerjes, por nuk morën përgjigje çka nëse kontrata ka qene e dëmshme. Zyrat e shkatërruara janë një dëshmi pse janë bërë të tilla, sepse kontratat e lidhura gjatë procesit të shitjes së ndërmarrjeve ka pasur parregullsi të mëdha. Në rastin e shitjes së “Sharr-Cem-it” është marrë për bazë kontrata e viti 2000. Kompania, që ka punuar, nga ky vit ka përfituar dhe kësaj i është krijuar një privilegj nga UNMIK-u gjatë kësaj kohe. Pastaj edhe nga AKP-ja i është krijuar një privilegj i dytë. Këtu ka korrupsion të jashtëzakonshëm. Mungesa e transparencës është procesi tjetër që e ka shoqëruar që në punësimin e këshilltarëve. Është evidente se nuk është punuar për interesat e kompanisë, pra nuk është bërë ajo që është më normalja - konkurrenca për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Mënyra se si është shitur kjo ndërmarrje krijon rast precedent. Është momenti për përgjegjësi penale, është momenti për hetimin e kësaj çështjeje.

Muhamet Mustafa - Auditori nuk është i bindur se është caktuar vlera e tregut para se të privatizohet ndërmarrja. Agjencia e ka angazhuar konsulencën dhe e ka formuar komisionin, por këto janë çështje diskutabile. Problem është komercializimi, që e ka paraparë edhe neni 4.7. Megjithatë, sipas AKP-së, ekziston bindja se është vlera e tregut përcaktuese, por kjo nuk është bindëse. Ndërmarrjet e tjera duhet të shkojnë në procedurën e garës objektive, pavarësisht nenit 4.7.

Naim Avdiu – Auditori nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme rreth punës së AKP-së. Në Raportin e ZAP-it thuhet se AKP-ja e ka bazën e vet ligjore. Nëse AKP-ja merret vetëm me Ligjin e AKP-së, atëherë i trasohet rruga dhe nuk merret me gjithë spektrin e Agjencisë me të cilin duhet të veprojë, të punoj dhe të marrë vendime. Me një bazë të tillë ligjore, siç është bazuar auditori, nuk ka mundur të vihet në një përfundim tjetër, pos të asaj në të cilin ka ardhur ai. Bazuar në standardet e auditimit njohurit e auditorit lidhur me biznesin ndihmojnë në: identifikimin e ngjarjeve, transaksioneve dhe të praktikave, që mund të kenë efekt material në pasqyrat financiare. Çështjet, që duhet të merren parasysh nga auditori për zhvillimin e planit të përgjithshëm të auditivit, i përfshijnë: njohuritë lidhur me bizneset. Në kudër të këtyre njohurive faktorët duhet të merren parasysh faktorët e përgjithshëm ekonomikë dhe kushtet e industrisë që ndikojnë në aktivitetin e entitetit. Legjislacionin dhe rregulloret që ndikojnë në veprimtarinë e entitetit. Pra ZAP-i është kufizuar vetëm në Ligjin e AKP-së e jo me bazën ligjore, me të cilën vepron AKP-ja e që rrjedhin nga viti 2000.

“Sharr Salloniti” – ndërmarrjet që ndodhen nën administrim të drejtpërdrejtë, fillimisht Agjencia e përcakton bordin menaxhues të ndërmarrjes, që i raporton zyrës së administrimit të drejtpërdrejtë në AKP. Plani investiv i ndërmarrjes është bazuar në kërkesën e doganave të Kosovës që punojnë dhe veprojnë në hapësirën gjeografike të ndërmarrjes. Kjo kërkesë i është drejtuar AKP-së e jo Bordit Mbikëqyrës të ndërmarrjes. Njoftimi në gazetë për tender të hapur, në të cilin shkruan se dokumentacioni i kompletuar të vendoset në pliko të mbyllura dhe të dorëzohet në AKP. Komisioni e ka bërë pranimin dhe hapjen e ofertave. I gjithë procesi ka qenë nën mbikëqyrjen e AKP-së. AKP-ja i lejon ndërmarrjes “Sharr Sallonit” ta ndërtojë objektin. Kjo mungon. Auditori procesin e administrimit të drejtpërdrejtë nuk e ka konsideruar si mbikëqyrje nga ana e AKP-së. Ka pasur dosje të tenderit, por jo të bazuar në LPP.

Ramiz Lladrovci – Përfaqësuesit e Doganës së Kosovës kanë thënë se AKP-ja e ka shitur këtë objekt me kusht që blerësi ta lejojë Doganën për shfrytëzimin e këtij objekti pa qira.

Dino Asanaj – AKP-ja nuk e ka obliguar blerësin që këto objekte të shfrytëzohen pa qira për tri vjet. Personi më i lartë vendor në AKM ka qenë zëvendësudrejtor. Të tjerët kanë qenë ndërkombëtarë.

Avni Jashari – Ofertat në formë elektronike – në procesin e parë tenderues janë dorëzuar dy oferta me pliko të mbyllura. Bordi i Drejtorëve e ka autorizuar Komisionin që ka marrë vendim që forma e pranimit të ofertave të jetë në formë elektronike me fjalëkalim. Ofertuesit po ashtu do t'i dorëzojnë edhe ofertat e mbyllura dhe të dy ofertat do të krahasohen. Komisioni i caktuar nga Bordi nuk ka gjetur mospërputhje. Çdo transaksion në Kosovë bëhet nëpërmjet llogarisë së vetme të thesarit, MF dhe BQ. Në mars të vitit 2008 ish-shefi i Shtyllës së Katërt dhe drejtori i menaxhmentit të Shtyllës së Katërt i kanë dërguar letër të gjithë të punësuarve në AKM, ku i kanë njoftuar me datat e sakta të ndërprerjes së kontratave. Ka ekzistuar një zbrazëti prej 1 korrik 2008 deri më 26 gusht 2008, në të cilën për sigurinë e dokumenteve është përkujdesur ose moskujdesur siguri i Shtyllës së Katërt të UNMIK-ut.

Shkëlzen Lluka – AKM-ja ka qenë e udhëhequr nga ndërkombëtarët. Të gjithë drejtorët e të gjitha departamenteve kanë qenë ndërkombëtarë, të udhëhequr nga shtylla e katërt e UNMIK-ut.

Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm – Atë që ne auditorët e njohim si kuptimi i punës ose i afarizmit të ndonjë entiteti, nuk do të thotë se duhet ta njohim punën shumë më mirë se entiteti që duhet audituar. Puna më e madhe në këtë Raport është çështja e “Sharr-Cemit”, sepse çmimet nuk janë caktuar në mënyrë reale. Këto studime, që janë bërë, nuk e ofrojnë atë çmim. Dokumentet brenda Agjencisë kanë reflektuar për mënyrën se si të arrihet çmimi, por kjo nuk ka qenë pjesë e studimit të ZAP-it. Është e rëndësishme të nxirret një konkluzion dhe të ndërmerret diçka në nivel më të lartë.

Valbon Bytyçi – Me Kushtetutën e Kosovës, neni 119, veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë janë të ndaluara. Në Ligjin e AKP-së përcaktohet se për secilën shitje do të aplikohen procedurat e hapura, do të thotë të bëhet me treg të hapur. Zyra Ligjore e AKP-së e ka dhënë opinionin që shitja e “Sharr-Cemit” të bëhet me procedura të hapura. Shitja e “Sharr Sallonitit”, nuk ka pasur miratim në Bord. Nëse kjo nuk është bërë me procedurat e Ligjit të prokurimit publik, atëherë nuk e di çfarë procedurash të tjera janë ndjekur. Janë ndjekur disa procedura por miratim prej Bordit nuk kishte.

Vërejtja jonë te avancat ka qenë pse ato janë prezantuar si shpenzime kur kanë qenë avanca.

Te ndërmarrja *Egi Bau*, nuk janë përmblusur të gjitha zotimet. Nuk është përmblusur kriteri i qirasë. 952 m² kanë qenë të uzurpuara. Për këtë arsye nuk është paguar qiraja, kurse në shfrytëzim kanë qenë 4352 m². Kjo nuk është arsyetim që të mos paguhet komplet qiraja.

Te 20% i punëtorëve, lista ka qenë e hartuar në vitin 2006, kurse pagesat janë ekzekutuar në vitin 2010.

Dino Asanaj - Kur ka filluar procesi i privatizimit, për 5 - 6 vjet ka qenë një autoritet, me imunitet diplomatik, pa përgjegjësi dhe pa llogaridhënie. Nga viti 2008 ne raportojmë sipas obligimeve ligjore. KMFP-ja dhe ZAP-i duhet t'i kenë parasysh disa rrethana, kur e kemi shitjen e një fabrike (“Sharr-Cem”), që nuk ka rezerva dhe është shitur më shumë se “Feronikeli” që ka rezerva edhe për 50 vjetët e tjera. Komercializuesi ka pasur të drejtë ta marrë edhe makinerinë, që do ta kishte shitur si hekurishte, ashtu siç i ka shitur AKM-ja disa të tjera. Ose ka mund t'i shesë, siç i ka shitur dy miniera, “Mimi” dhe “Ximi”, që kanë rezerva për 50 vjet, vetëm për 800,000, kurse ne e kemi shitur për 65 milionë fabrikën. Këto duhet të krahasohen. Ne kërkojmë nga Komisioni auditim të performancës.

Me kalimin e kompetencave nga AKM-ja te AKP-ja, AKM-ja ka refuzuar ta mbajë takimin e fundit më 21 maj 2008 dhe ta bëjë dorëzimin. Shtylla e IV e ka zvarritur procesin deri në gusht. Kur ne kemi hyrë në ndërtesën e Agjencisë nuk kemi gjetur asgjë, përveç të djegurave dhe mbeturinave. Serverin dhe formën elektronike na e kanë dorëzuar në fund të shtatorit, në saj të marrëveshjes që është bërë me Zanierin për kthimin e dokumentacionit. Për ta marrë grandin nga Komisioni Evropian, ka qenë kusht kthimi i punëtorëve të AKM-së në punë. Punëtorët 3 - 4 muaj kanë punuar pa paga.

Valbona Dibra – Pati vërejtjen se kryetari i komisionit nuk i dha fjalën për diskutim gjatë shqyrtimit të raportit me përfaqësuesit e AKP-së. Përfaqësuesit e AKP-së e dhanë një sqarim të

mirë lidhur me të gjeturat e ZAP-it. Propozoi që ZAP-i ta bëjë një auditim të performancës me një ekspert që e njeh këtë lëmi e jo të bëjë vlerësim, sepse auditimi i rregullsisë nuk e pasqyron anën efektive të këtij fondi.

Kryesuesi - A mund të bëhet auditimi i performancës vetëm për “Sharr-Cem-in”?

Muhamet Mustafa - A është e mundur të anulohen kontratat në këto raste?

Afrim Hoti – Pse ZAP-i nuk i është drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit ose prokurorisë, pasi i ka konstatuar të gjitha këto shkelje të ligjit.

Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm – ZAP-i nuk ka kapacitete për ta kryer auditimin e performancës së Fondit të Privatizimit. Kjo është e mundur nëse angazhojmë një ekspert nga jashtë. Në këtë rast nuk mund të bëhet asgjë. Për rastet e ardhshme, janë disa dokumente që njihen si flamuj të kuq dhe i dërgohen AKK-së dhe prokurorisë, por në këtë Raport nuk ka fakte të mjaftueshme që do të mbështetëj kjo. Trajtimi i tyre e rrit rrezikun, por nuk është çështje faktike.

Kryesuesi – Komisioni pra kërkon nga ZAP-i, ta bëjë një auditim të performancës me një ekspert të auditimit të lartë. Komisioni mund të kërkojë nga Kuvendi ta mbështetë financiarisht këtë mundësi.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me propozimin e kryesuesit tha se ka implikime buxhetore dhe si i tillë nuk mund të realizohet. ZAP-i duhet ta bëjë auditimin e performancës dhe çështja e angazhimit të ekspertit është çështje e ZAP-it. Raporti i rregullsisë, i proceduar në këtë Komision për Fondin e Privatizimit, nuk duhet të miratohet nga Komisioni.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

1. Të kërkoj nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që në bazë të nenit 3.7 të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr. 03/L-075, të bëjë një auditim të performancës së Fondit të Privatizimit.
2. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit

4. Të ndryshme

a) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit në Kosovë

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëllojë e nxori këtë

Përfundim

Komisioni do ta bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës nr. 03/L-075.

Formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës: Valbona Dibra – raportuese, Armend Zemaj – anëtar dhe Mursel Haljilji – anëtar.

Raporti me rekomandime i grupit punues i paraqitet Komisionit për shqyrtim dhe për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 18:40.
E Përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu